

# Newsletter

Korrik 2026

*1 dekadë zëri i  
prodhuesve shqiptarë*

N°2



## **Mblidhet Asambleja e Përgjithshme! Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë prezanton vizionin për dekadën e re**

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë shënoi një etapë të rëndësishme për të ardhmen e Shoqatës dhe të industrisë prodhuese në vend.

Në fokus të diskutimeve ishin ristrukturimi i Shoqatës, vizioni për 10-vjetorin dhe një qasje e re në përfaqësimin, komunikimin dhe mbështetjen e anëtarëve të saj.

Gjatë Asamblesë, prodhuesit ngritën problematikat kryesore që ndikojnë në zhvillimin e industrisë, duke theksuar nevojën për më shumë konsultim publik, drejtësi fiskale, lehtësim të barrës administrative, ulje të kostove të prodhimit, zhvillim të kapitalit njerëzor, përmbushje të standardeve të Bashkimit European, si dhe adresim të çështjeve mjedisore.

Asambleja konfirmoi një drejtim të qartë: një Shoqatë më pranë anëtarëve dhe më e angazhuar në ndërtimin e një dialogu të qëndrueshëm me institucionet për çështjet që prekin industrinë prodhuese.

**Për më shumë**→<https://prodhuesit.org/mblidhet-asambleja-e-pergjithshme-bashkimi-i-prodhuesve-shqiptare-prezanton-vizionin-per-dekaden-e-re-2/>

---

## Nis partneriteti me Dhomën Zejtare të Dortmundit për kualifikimin e fuqisë punëtore

Një industri më konkurruese nis nga një fuqi punëtore më e kualifikuar. Me këtë vizion, Dhoma Zejtare e Dortmundit, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Shkolla Profesionale "Karl Gega" po ndërtojnë një partneritet strategjik për forcimin e arsimit profesional dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor në Shqipëri.



Gjatë workshop-it të përbashkët për gjetjen e fakteve të Projektit Federal "Partneriteti për Arsim Profesional në Shqipëri", ekspertët e Dhomës Zejtare të Dortmundit, përfaqësuesit e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë, të Shkollës Profesionale "Karl Gega"

dhe partnerët institucionalë diskutuan objektivat e projektit, modulet e trajnimit dhe modelin e bashkëpunimit mes biznesit, arsimit profesional dhe institucioneve.



Projekti synon zhvillimin e programeve moderne të formimit profesional, të orientuara drejt praktikës dhe kërkesave të tregut të punës, forcimin e bashkëpunimit mes ndërmarrjeve dhe shkollave profesionale, si edhe përmirësimin e cilësisë së arsimit profesional sipas standardeve ndërkombëtare.

Projekti mbështetet nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë (BMZ) dhe shënon një hap konkret drejt ndërtimit të një fuqie punëtore që i përgjigjet nevojave të industrisë shqiptare.

**Për më shumë**→<https://prodhuesit.org/bashkimi-i-prodhuesve-shqiptare-nis-bashkepunimin-me-dhomen-zejtare-te-dortmundit/>

# Një dekadë e re kërkon një qasje të re! CIPE asiston ristrukturimin e Bashkimit të Prodhuesve Shqiptarë



Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë ka nisur procesin e transformimit dhe ristrukturimit të Shoqatës përmes një partneriteti me Center for International Private Enterprise (CIPE), e cila do të asistojë në forcimin e kapaciteteve organizative, fuqizimin e rolit advokues dhe përfaqësimin më efektiv të çështjeve prioritare të industrisë prodhuese.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, përfaqësues të Shoqatës morën pjesë në workshopin dyditor të organizuar nga CIPE, së bashku me organizata të biznesit nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

Workshopi krijoi një hapësirë të vlefshme për shkëmbimin e përvojave, ndërtimin e partneriteteve të reja dhe diskutimin e praktikave që forcojnë rolin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e organizatave të biznesit.

Ky partneritet shënon fillimin e një etape të re për Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë, me synimin për të ndërtuar një organizatë edhe më të fortë, më moderne dhe më efektive në përfaqësimin e interesave të prodhuesve shqiptarë.

---

## **“Made in Albania” drejt ligjit: Prodhuesit japin kontributin për markën kombëtare**



Procesi për hartimin e projektligjit **“Made in Albania”** ka hyrë në një fazë të rëndësishme konsultimesh me biznesin. Gjatë muajit maj, Shoqata **“Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”**, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, zhvilloi një seri tryezash me prodhuesit dhe grupet e interesit për të mbledhur propozime konkrete mbi përmbajtjen e ligjit.

Në fokus të diskutimeve ishin kriteret për certifikimin e markës shqiptare, masat mbështetëse për bizneset që do të certifikohen, rritja e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, promovimi në tregjet ndërkombëtare dhe përafrimi me standardet e Bashkimit European. Përfaqësuesit e industrisë ushqimore dhe sektorit të artizanatit ngritën gjithashtu shqetësime për gjurmueshmërinë, kontrollin e cilësisë, aksesin në lëndë të parë, mungesën e laboratorëve certifikues, fuqinë punëtore dhe konkurrencën nga informaliteti.

Shoqata **“Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”** ritheksoi se **“Made in Albania”** duhet të jetë një instrument që rrit vlerën e prodhimit shqiptar dhe mbështet zhvillimin e industrisë, ndërsa Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit garanoi se propozimet e biznesit do të reflektohen në draftin përfundimtar të ligjit, përmes vijimit të konsultimeve edhe me sektorë të tjerë.



---

## Integrimi në BE: Nga informimi te transformimi i biznesit shqiptar

**Interviste Euronews Albania | Integrimi në BE nis me transformimin e biznesit**

Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës, Arben Shkodra, theksoi se integrimi në Bashkimin European kërkon një proces të menjëhershëm transformimi të sipërmarrjeve shqiptare. Për t'u bërë pjesë e tregut european, bizneset duhet të

investojnë në standarde, teknologji, procese prodhimi dhe përgatitjen e kapitalit njerëzor, duke përfituar nga koha e mbetur për t'u përshtatur me kërkesat e BE-së.

***Për më shumë*** →<https://prodhuesit.org/biznesi-shqiptar-te-nise-transformimin-per-integrimin-ne-be-perndryshe-sfida-mund-te-kthehet-ne-deshtim/>


## **Komiteti i Përbashkët Konsultativ BE–Shqipëri | Përgatitja për tregun evropian**

Në takimin e Komitetit të Përbashkët Konsultativ BE–Shqipëri u theksua se integrimi kërkon jo vetëm përafrimin e legjislacionit, por edhe standardizimin e produkteve, certifikimin e proceseve dhe një komunikim të vazhdueshëm me biznesin. Gjithashtu u nënvizua nevoja për të luftuar informalitetin dhe dezinformimin, si elementë që dëmtojnë konkurrencën e ndershme.



## Konferenca Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional | Aftësitë për industrinë e së ardhmes

Mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar mbetet një nga sfidat kryesore të integritimit evropian. Në Konferencën e 3-të Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional u theksua rëndësia e bashkëpunimit mes arsimit dhe sipërmarrjes për zhvillimin e aftësive profesionale dhe përgatitjen e kompanive për Industrinë 5.0.



## Integrimi i Biznesit në Tregun European | Kapitali njerëzor në qendër të transformimit

Gjatë aktivitetit të organizuar nga Swisscontact Albania dhe SWISSA Albania, u theksua se përgatitja e biznesit për tregun evropian nuk lidhet vetëm me teknologjinë dhe investimet, por edhe me zhvillimin e kapitalit njerëzor. Në fokus ishte edhe Programi Kombëtar për Mbështetjen e Biznesit, i cili synon të mbështesë transformimin gradual të kompanive drejt standardeve të Bashkimit Evropian.



St. Vaso Pasha, Nr 7  
Tiranë, Albania

**TEL:** +355 69 202 9944

**Email:** [info@prodhuesit.org](mailto:info@prodhuesit.org)

[Unsubscribe](#)